



ARKEP

AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS

**Rregullat e Ankandit
për
Alokimin e të drejtave
për shfrytëzimin e brezeve frekuencore për
Shërbimet BWA në brezet 3400 - 3800 MHz**

Prishtinë, Nëntor 2013

1. Korniza Ligjore dhe Rregullatore (baza Ligjore)

- 1.1 Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje; Autoriteti*) me datë; 18/11/2013 shpall procedurën e Ankandit për dhënien e Autorizimeve për përdorimin (shfrytëzimin) e brezeve 3400 – 3600 MHz dhe 3600 - 3800 MHz për ofrimin e shërbimeve brezëgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- 1.2 Ankandi shpallet dhe organizohet në përputhje me;
- 1.2.1 Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje; Ligji ose Ligjin*), Nenet; neni 10 paragrafi 10) dhe neni 51 paragrafët 1) dhe 2), me qëllim të;
- Sigurimit dhe nxitjes së konkurrencë efektive në ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, faciliteteve shoqëruese dhe shërbimeve tjera; si dhe
 - Zbatimit të prioritetëve dhe objektivave zhvillimore ekonomike të vendit dhe objektivave sociale si të përcaktuara me prioriteti 1), respektivisht objektivat 2) dhe 3) të dokumentit të politikave të sektorit të komunikimeve elektronike 'Azhenda Dixhitale 2013 - 2020';
- 1.2.2 Plani Kombëtar i Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Radiofrekuencor të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (*Ref. Vendimi Nr. 04-V-93, datë; 23/06/2011*);
- 1.2.3 Vendimit të organit drejtues dhe autoritetit ligjor, Bordit të Autoritetit për inicimin dhe organizimin e Ankandit për dhënien (caktimin) e brezeve frekuencore 3400 – 3600 MHz dhe 3600 - 3800 MHz për shërbimet brezëgjëra, përfshi përcaktimin e çmimit fillestar, kriterëve para-kualifikuese dhe kushteve tjera të përkufizuara me rregullat e Ankandit (*Ref. Konkluzionet e Bordit ARKEP Nr. Prot. 034/B/13*).
- 1.2.4 Vendimit Nr. 405 (*Ref.Nr. Prot.033/B/13*) për caktimin e Komisionit për administrimin e procedurave të ankandit (*tutje; Komisioni*).
- 1.3 Rregullat e Ankandit të publikuara përmes këtij dokumenti dhe Shtojcat përkatëse të tij janë dhe paraqesin të vetmen bazë dhe janë referencat e vetme zyrtare për pjesëmarrje dhe paraqitjen e ofertave.
- 1.4 Korrespondencat tjera nga Autoriteti nuk do jenë pjesë të dokumentacionit të Ankandit të shpallur nga Autoriteti në zbatim të rregullave të Ankandit.

2. Dispozitat e Përgjithshme dhe Subjekti i Ankandit

- 2.1 Kjo rregullore përshkruan procedurat e nevojshme për dhënien e të drejtave për shfrytëzimin e brezit 3400 – 3600 MHz dhe 3600 - 3800 MHz, nga Autoriteti, në territorin e

Republikës së Kosovës, si dhe vendos parimet, procedurat dhe rregullat e administrimit të Ankandit nga Komisioni respektivisht Autoriteti.

- 2.2 Subjekt i Ankandit do jetë lëshimi i Autorizimit-eve përkatëse nga Autoriteti për përdorimin (shfrytëzimin) e radio frekuencave në blloqet frekuencore të brezeve 3400 – 3600 MHz dhe 3600 - 3800 MHz për ofrimin e shërbimeve brezëgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

3. Ankandi

- 3.1 Pjesëmarrës në ankand mund të jetë; një operator, ndërmarrës apo ndërmarrje (*kompani, biznes, etj*) e regjistruar, e cila ka paraqitur kërkesën (aplikuar) në përputhje me procedurat e përshkruara në këtë dokument dhe i plotëson kriteret para-kualifikuese të përcaktuara në pikën 3.2.
- 3.2 Pjesëmarrës në ankand mund të jenë operatorët /ndërmarrjet të cilët;
- 3.2.1 Janë të pajisur me Autorizim të Përgjithshëm dhe/apo Licencë për ofrimin e shërbimeve komunikuese elektronike;
- 3.2.2 Kanë qenë aktiv së paku tri (3) vitet e fundit në ofrimin e shërbimeve komunikuese elektronike. Një gjë e tillë duhet të dëshmohet duke sjellë dokumentet përkatëse të lëshuara nga organet kompetente.
- 3.2.3 Të hyrat e operatorit/ndërmarrësit për tri (3) vitet e fundit në/nga ofrimi i shërbimeve komunikuese elektronike kanë qenë së paku; 5,000,000.00 EUR.
- 3.2.4 Pagesa e taksës administrative për pjesmarrje në shumë prej 2,500.00 EUR .
- 3.3 Spektri frekuencor i ofruar në Ankand; 3410 – 3490/ 3510 – 3590 MHz dhe 3600 – 3800 MHz është ndarë në blloqet si më poshtë;

Tabela 1). Ndarja e blloqeve për Brezin 3400 – 3600 MHz

Numri rendor i kanalit	Bloku frekuencor	Gjerësia e bllokut	Brezi i poshtëm (MHz)	Brezi i epërm (MHz)	Koment
1 – 4	A	2x20 MHz	3410.0 – 3430.0	3510.0 – 3530.0	Nacionale
5 - 8	B	2x20 MHz	3430.0 – 3450.0	3530.0 – 3550.0	Nacionale
9 - 12	C	2x20 MHz	3450.0 – 3470.0	3550.0 – 3570.0	Nacionale
13 - 16	D	2x20 MHz	3470.0 – 3490.0	3570.0 – 3580.0	Nacionale

Tabela 2). Ndarja e blloqeve për Brezin 3600 – 3800 MHz

Gjerësia e bllokut	Bloku frekuencor	Brezi (MHz)	Bloku frekuencor	Brezi (MHz)	Koment
10 MHz	A1	3600.0 – 3610.0	K1	3700.0 – 3710.0	Nacionale
10 MHz	B1	3610.0 – 3620.0	L1	3710.0 – 3720.0	Nacionale
10 MHz	C1	3620.0 – 3630.0	M1	370.0 – 3730.0	Nacionale
10 MHz	D1	3630.0 – 3640.0	N1	3730.0 – 3740.0	Nacionale
10 MHz	E1	3640.0 – 3650.0	O1	3740.0 – 3750.0	Nacionale
10 MHz	F1	3650.0 – 3660.0	P1	3750.0 – 3760.0	Nacionale
10 MHz	G1	3660.0 – 3670.0	Q1	3760.0 – 3770.0	Nacionale
10 MHz	H1	3670.0 – 3680.0	R1	3770.0 – 3780.0	Nacionale
10 MHz	I1	3680.0 – 3690.0	S1	3780.0 – 3790.0	Nacionale
10 MHz	J1	3690.0 – 3700.0	T1	3790.0 – 3800.0	Nacionale

3.4 Çmimi fillestar i përcaktuar nga Autoriteti paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Vlera e spektrit për 1 MHz	5 400.00 EUR
Vlera e spektrit për një bllok 2x20 MHz (40 MHz)	216 000.00 EUR
Vlera e spektrit për një bllok 10 MHz	54 000.00 EUR
Vlera totale e spektrit për brezin 3400 – 3800 (360 MHz)	1 944 000.00 EUR

Gjatë zhvillimit të ankandit çmimi do rritet pas çdo raundi duke i shtuar vlerës së raundit paraprak vlerën e çmimit inkremental që do jetë 2,500.00 EUR për blloqet 2x20 MHz në brezin 3400 – 3600 MHz dhe 1,000.00 EUR për blloqet 10 MHz në brezin 3600 - 3800 MHz.

Ofertat valide janë të përcaktuara dhe pjesëmarrësi duhet ta ngrit ofertën duke i shtuar ofertës minimale të raundit (*çmimi fillestar/oferta më e lartë e raundit paraprak plus çmimi inkremental*) vlerën e njëres nga ofertat valide të njërive ofertuese si mëposhtëm;

- Oferta minimale plus 1 njësi ofertuese (100€)
- Oferta minimale plus 5 njësi ofertuese (500€)
- Oferta minimale plus 10 njësi ofertuese (1,000€)
- Oferta minimale plus 20 njësi ofertuese (2,000€)
- Oferta minimale plus 50 njësi ofertuese (5,000€)
- Oferta minimale mbi 50 njësi ofertuese do të jetë (N x 5,000€; N= 2,3,4,5...n)

3.5 Të drejtat për shfrytëzimin e brezit frekuencor 3400 – 3600 MHz do ti alokohen gjithsej katër (4) fituesve, ndërsa numri i fituesve për brezin frekuencor 3600 – 3800 MHz nuk është i përcaktuar. Secili fitues mund ti sigurojë të drejtat për shfrytëzimin e brezit frekuencor për vetëm një (1) bllok në brezin 3400 – 3600 MHz dhe disa blloqe por JO më shumë se 5 blloqe në brezin 3600 – 3800 MHz njëkohësisht.

3.6 E drejta për shfrytëzim apo kohëzgjatja e autorizimit për secilin bllok në brezin 3400 – 3800 MHz do të jetë 15 vjet nga momenti i dhënies së autorizimeve. Spektri duhet të përdoret në mënyrë efikase dhe efektive për ti përmbushur nevojat e konsumatorëve, si dhe në pajtim me Ligjet dhe Rregulloret e aplikueshme të Autoritetit, si dhe kushtet e përcaktuara në/me Autorizimin për shfrytëzimin e resurseve frekuencore të lëshuar nga Autoriteti.

4. Parimet e Ankandit

4.1 Çfarëdo marrëveshje në mes të pjesëmarrësve të ankandit për pjesëmarrje ose mos-pjesëmarrje në ankand apo ndonjë marrëveshje për strategjinë e pjesëmarrjes në ankand është e ndaluar.

4.2 Marrëveshje e pa-ligjshme nënkupton çfarëdo marrëveshje gojore apo në formë të shkruar (duke përfshirë edhe harmonizimin e ndërsjellë) në mes të pjesëmarrësve, duke ndarë informacione apo rënë dakord për aktivitete të cilat do të ndikonin në rezultatet e ankandit.

4.3 Pjesëmarrësit e ankandit duhet të paraqesin informacione të vërteta, të plota dhe të sakta dhe mbahen përgjegjës për vërtetësinë e informacioneve të ofruara.

5. Përfaqësuesit dhe pjesëmarrësit në ankand

5.1 Pjesëmarrës në ankand mund të jenë ato ndërmarrje/konsorciume, të cilat kanë paraqitur aplikacionin në përputhje me procedurat e ankandit dhe kriteret e specifikuar në pikën 3.2 të këtij dokumenti si dhe ka siguruar dhe paraqitur garancionin valid bankar. Një aplikacioni mund të dorëzohet nga një grup/konzorcium i operatorëve ekonomik.

Në këtë rast grupi, së bashku me aplokacionin e tyre, **duhet dorëzoj një deklaratë të qartë ku :**

- a. të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e aplikacionit të grupit, dhe në rast se grupi është fitues i ndonjë blloku frekuencor, ti kryej të gjitha obligimet e parapara konform rregullave të ankandit ;
- b. konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të ankandit ; dhe
- c. të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit.

5.1.2 Një grupi të tillë nuk ***do t'i kërkohet të ketë formë të caktuar ligjore*** në mënyrë që të dorëzoj aplikacionin, por Autoriteti rezervon të drejtën, nëse një kërkesë e tillë është e nevojshme që të kërkoj nga grupi i përzgjedhur të ketë formë ligjore nëse është fitues i ndonjë blloku.

- 5.2 Në qoftë se një aksionar është pjesë e dy apo më shumë ndërmarrjeve (*tutje ndërmarrjet e lidhura, që do të thotë kanë një aksionar të përbashkët i cili ka mbi 10% të aksioneve në secilën nga ndërmarrja*) atëherë ndërmarrja e lidhur përjashtohet nga pjesëmarrja në ankand në qoftë se njëra nga ndërmarrjet ka dorëzuar paraprakisht dokumentet për pjesëmarrje në ankand (*lejohet vetëm e para*).
- 5.3 Çdo pjesëmarrës në ankand duhet të emëroj jo më shumë se dy (2) përfaqësues për pjesëmarrje. Përfaqësuesit mund të jenë ligjor apo të autorizuar (*tutje; Përfaqësuesit*). Pjesëmarrësit në ankand duhet ta dëshmojnë dhe vërtetojnë këtë fakt duke sjellë dokumentin e noterizuar për të autorizuarin (*Autorizimi i dhënë në Shtojcën 2*) që dëshmojnë kompetencën e deleguar.
- 5.4 Aktivitetet e përfaqësuesit gjatë ankandit (*duke përfshirë edhe informacionet dhe ofertat e ofruara nga përfaqësuesit*) janë dhe mbesin të detyrueshme.

6. Paraqitja e kërkesës/ aplikacioneve

- 6.1 Pjesëmarrësi duhet të dorëzojë pranë Autoritetit një kopje origjinale të aplikacionit të plotësuar për pjesëmarrje (*Aplikacioni është dhënë në Shtojcën 1*) dhe të nënshkruar nga pjesëmarrësi. Aplikacionin mund të shkarkohet nga ueb faqja zyrtare e Autoritetit në linkun www.arkep-rks.org/?cid=1,199.
- 6.2 Me kompletimin e aplikacionit për regjistrim, pjesëmarrësi pajtohet se aplikacioni është në përputhje me rregullat dhe kushtet e përcaktuara nga Autoriteti.
- 6.3 Pjesëmarrësi duhet të njoftojë me shkrim menjëherë për çfarëdo ndryshimi të informacioneve pas regjistrimit, në qoftë se kupton se aplikacioni përmban ndonjë informacion jo të plotë apo jo të saktë.
- 6.4 Ndryshimet e përshkruara në pikën 6.3 duhet të nënshkruhen nga pjesëmarrësi i ankandit.
- 6.5 Paraqitja e kërkesës përveç aplikacionit duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme të cilat janë pjesë integrale e këtij dokumenti;
- 6.5.1 Deklarata e plotë e konformitetit (*e dhënë në Shtojcën 3*);
- 6.5.2 Garancioni bankar, në përputhje me pikat 7.1 dhe 7.2 të këtij dokumenti (*e dhënë në Shtojcën 4*);
- 6.6 Pjesëmarrësi duhet ti dorëzoj dokumente origjinale ose kopje të noterizuara të kërkuara, të cilat duhet të përmbajnë informacionet e fundit, të azhurnuara apo informacionet plotësuese të kërkuara.
- 6.7 Pjesëmarrësit duhet ti dorëzojnë dokumentet në njërën nga gjuhët zyrtare. Në qoftë se dokumentet janë në ndonjë gjuhë të huaj, atëherë kopjet e përkthyer duhet të jenë

legjitime (përkthime të autorizuar) në pajtim me Ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

7. Garancioni Bankar

7.1 Pjesëmarrësi në ankand deri me datë; 09/12/2013 (*afati i fundit për paraqitjen e kërkesave/aplikacioneve*) duhet të paraqesë garancionin bankar të lëshuar nga cilado bankë komerciale e licencuar nga BQK dhe regjistruar sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës(*është dhënë në Shtojcën 4*).

7.2 Garancioni bankar duhet ti adresohet Autoritetit (*Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, Rr. Pashko Vasa, Nr. 12, Prishtinë, 10000*), si dhe të jetë i nënshkruar nga personi/zyrtari përgjegjës i bankës dhe të përmbajë së paku informacionet e mëposhtme;

- i. Vlerën prej 25,000.00 EUR;
- ii. Llogaria e përfituesit (*Llogaria bankare e ARKEP*) ku adresohet pagesa;
- iii. Identifikimi i saktë i bankës garantuese;
- iv. Përfituesi (*ARKEP*);
- v. Identifikimi i saktë i garantuesit;
- vi. Periudhën e vlefshmërisë së garancionit 90 ditë nga data e fillimit të ankandit;
- vii. Efektiviteti i garancionit, që jepet nga data e lëshimit;
- viii. Kushtet për përdorimin/shfrytëzimin e garancionit bankar, në veçanti;
 - a) Disbursimi sipas kërkesës fillestare, pa ndonjë kundërshtim;
 - b) Të jetë i pa-revokueshëm;
 - c) Të jetë i pakushtëzuar;
 - d) Të mos jetë i transferueshëm.
- ix. Një formë e detyrimit të përfituesit për garantuesin (bankën), domethënë një kërkesë në formë të shkruar (pranimi i përfituesit) e protokolluar, ku data e vendosur duhet të jetë data e pranimit nga banka.

7.3 Garancioni bankar i dorëzuar në përputhje me pikën 7.2 do të kthehet:

7.3.1 kur pjesëmarrësi i ankand i cili nuk e ka fituar në ankand. Kthimi bëhet brenda 5 ditë pune pas konfirmimit/validimit të rezultateve të ankandit .

7.3.2 në rast se Bordi i Autoritetit nuk e aprovon rezultatet e ankandit, garancioni bankar i dorëzuar në përputhje me pikën 7.2 do të iu kthehen të gjithë pjesëmarrësve të ankandit brenda 5 ditë të punës, pasi është marrë vendimi përkatës.

7.3.3 ka dorëzuar garancionin e paguar në përputhje me pikën 7.2, por nuk ka marr pjesë në ankand;

7.4 Autoriteti nuk e kthen Garancionin bankar të dorëzuar në përputhje me pikën 7.2 në këto raste:

7.4.1 tërheq ofertat e veta ose refuzon të nënshkruajë protokollin për ofertën më të lartë (të ofertuar nga pjesëmarrësi);

7.4.2 pjesëmarrësi me ofertë më të lartë në raundin e radhës jep ofertë të pavlefshme (*shuma e ofruar është më e vogël se oferta minimale e pranueshme për raundin apo vlera e ofertës nuk është e vlefshme*).

7.4.3 është përjashtuar nga pjesëmarrja në ankand bazuar në pikat 10.4 dhe 11.26 ;

7.4.4 nuk vepron në përputhje me rregullat e përcaktuara si në pikën 13.1

8. Konsultimi me Komisionin e Ankandit

8.1 Çdo person mund të kërkojë sqarim-e me shkrim për çfarëdo paqartësi lidhur me ankandin jo më vonë se një (1) javë para afatit të fundit për paraqitjen e kërkesave; Datë; 02/12/2013 ora 16 h00 (GMT+1).

8.2 Pas dorëzimit të aplikacionit për regjistrim, çdo shkëmbim i informacioneve në mes të komisionit të ankandit dhe pjesëmarrësit duhet të jetë me shkrim.

8.3 Kërkesat për informacione sqaruese duhet të dorëzohen me shkrim përmes postës apo në formë elektronike në E-mail adresën; ankandi@arkep-rks.org ose në numrin kontaktues + 381 38 212 345. Personi i cili i parashtron pyetje komisionit të ankandit duhet të specifikojë në subjektin e shkresës; 'Ankandi për brezin frekuencor 3400 – 3800 MHz' si dhe të specifikojë emrin e personit (*personi juridik*) që parashtron pyetjen dhe informacionet për kontakt (*e-mail adresa, adresa postare dhe numri i telefonit*).

8.4 Komisioni i ankandit do i kthejë përgjigje në formë të shkruar të gjithë të interesuarve.

8.5 Përgjigjet për të gjitha pyetjet e parashtruara do të publikohen në ueb faqen zyrtare të Autoritetit www.arkep-rks.org/ankandi/ duke mos e identifikuar personin i cili ka parashtruar pyetjen.

9. Regjistrimi

9.1 Pjesëmarrësi dorëzon aplikacionin për regjistrim në zarf të mbyllur personalisht tek zyrtari i autorizuar nga Komisioni i Ankandit, jo më vonë se me datë; 09/12/2013, 12h00 (GMT+1).

- 9.2 Zarf i duhet të identifikohet duke përmbajtur subjektin 'Ankandi për brezin frekuencor 3400 – 3800 MHz', adresën e Autoritetit (Rr. Pashko Vasa, Nr. 12, Prishtinë, 10000).
- 9.3 Zyrtari i autorizuar nga Komisioni regjistron pranimin e zarfit në një fletë-pranuese të veçantë, në dy (2) kopje, duke identifikuar emrin e pjesëmarrësit, datën dhe orën kur është pranuar zarfi për regjistrim. Një kopje e fletë pranimit të aplikacionit/zarfit i dorëzohet pjesëmarrësit.
- 9.4 Zarf i dorëzuar pas datës dhe orës së specifikuar në pikën 9.1 konsiderohet si jo i vlefshëm. Një zarf i tillë nuk do të hapet nga Autoriteti dhe do të kthehet palës. Në të gjitha rastet tjera dokumentet e paraqitura për regjistrim nuk kthehen.
- 9.5 Njohja dhe prezantimi i aplikuesve nga Komisioni do bëhet në ora 16:00, ndërsa ankandi do të fillojë ditën e nesërme me fillim nga ora 10h00 (GMT+1).

10. Konfidencialiteti i informacioneve

- 10.1 Me paraqitjen e kërkesës për regjistrim, pjesëmarrësi pajtohet se komisioni i ankandit do të përdorë dokumentet dhe informacionet e dorëzuara nga pjesëmarrësi vetëm për aktivitet në lidhje me ankandin.
- 10.2 Informacionet në lidhje me ankandin dhe procesin e ankandit janë të hapura, me përjashtim gjatë ditës së ankandit, para se ankandi të fillojë;
- 10.2.1 Numri i aplikacioneve të regjistruara;
- 10.2.2 Pjesëmarrësit e ankandit;
- 10.2.3 Numri i aplikacioneve të dorëzuara.
- 10.3 Komisioni i ankandit është përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e informacioneve konfidenciale.
- 10.4 Pjesëmarrësi i cili përmes aktiviteteve të tij synon që direkt apo indirekt, pa pëlqimin e pjesëmarrësve tjerë, të sigurojë informacione të cilat nuk janë publike, dhe në veçanti për strategjinë dhe taktikat e ankandit të pjesëmarrësve tjerë, shumat/ofertat që pjesëmarrësit kanë për qëllim ti ofrojnë, konsiderohen si shkelje mbi zbulimin e informacioneve konfidenciale.
- 10.5 Në qoftë se pjesëmarrësi i ankandit nuk i respekton kufizimet në pikën 10.4, e cila do të ndikojë dukshëm në rezultatet e ankandit, komisioni i ankandit ka të drejtë ta përjashtojë pjesëmarrësin e tillë nga ankandi.

11. Ankandi

- 11.1 Ankandi për brezet frekuencore 3410 – 3490/3510 – 3590 (MHz) dhe 3600 – 3800 MHz do të fillojë me datë; 10/12/2013, në ora 10:00 (GMT +1), në Prishtinë, Rr. Pashko Vasa, Nr. 12, 10000. Çfarëdo ndryshimi lidhur me datën dhe vendin, do të publikohen në ueb faqen zyrtare të Autoritetit.
- 11.2 Në qoftë se, ankandi duhet të vazhdojë edhe pas datës së paraparë në paragrafin e mësipërm, atëherë ankandi do të zhvillohet gjatë ditëve të punës nga ora 10:00 – 15:00. Komisioni, respektivisht drejtuesit e ankandit do ti njoftojnë pjesëmarrësit për detajet më të hollësishme rreth ankandit.
- 11.3 Ankandi do të organizohet dhe administrohet në gjuhën zyrtare (gjuhën shqipe). Në qoftë se ndonjëri nga pjesëmarrësit gjatë ankandit duhet të përdorë ndonjë gjuhë të huaj, pjesëmarrësi duhet të sigurojë interpretues/përkthyes dhe është përgjegjës për saktësinë e përkthimit.
- 11.4 Ankandi hapet nga drejtuesi/menaxheri i ankandit i cili i njofton pjesëmarrësit mbi blloqet frekuencore, çmimin fillestar, dhe vlerën e çmimit inkremental/rritës pas çdo raundi, si dhe lidhur me proceset e planifikuara të ankandit.
- 11.5 Komisioni i ankandit do të hapë zarfet sipas radhës që janë pranuar dhe duhet të verifikojë nëse;
- 11.5.1 Pjesëmarrësi i plotëson kriteret para-kualifikuese për pjesëmarrje në ankand;
- 11.5.2 Pjesëmarrësi i është përmbajtur rregullave të përcaktuara me rregulloren e ankandit;
- 11.5.3 Informacionet janë të sakta;
- 11.5.4 Dokumentet, aplikacioni si dhe garancioni bankar janë të vlefshme.
- 11.6 Nëse komisioni i ankandit konstaton se dy apo më shumë pjesëmarrës janë pjesë e kompanive të lidhura, atëherë komisioni cakton një afat prej jo më shumë se një orë për pjesëmarrësit në ankand të cilët përfaqësojnë kompanitë e lidhura, për të vendosur se cili nga pjesëmarrësit do të merr pjesë në ankand. Në qoftë se përfaqësuesit e kompanive të lidhura nuk mund të vendosin atëherë komisioni vendos sipas pikës 5.2.
- 11.7 Komisioni i ankandit i pranon si pjesëmarrës në ankand të gjithë pjesëmarrësit të cilët i plotësojnë kërkesat e përcaktuara me rregulloren e ankandit dhe kanë paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara.
- 11.8 Komisioni i ankandit nuk i pranon si pjesëmarrës në ankand, pjesëmarrësit të cilët;
- 11.8.1 nuk i kanë plotësuar kriteret para-kualifikuese;
- 11.8.2 kanë dështuar ti përmbahen kushteve të përcaktuara me rregulloren e ankandit;
- 11.8.3 kanë dorëzuar dokumente jo adekuate nga ato që janë kërkuar;

- 11.8.4 garancioni bankar nuk është i vlefshëm/valid;
- 11.8.5 pjesëmarrësit përfaqësojnë kompani të lidhura.
- 11.9 Në qoftë se paraqitet vetëm një pjesëmarrës në ankand, ky pjesëmarrës bëhet automatikisht fituesi i vetëm dhe është i obliguar të paguaj shumën e ofertuar e cila duhet të përmbaj çmimin fillestar plus çmimin inkremental dhe së paku një njësi ofertuese, të përcaktuar në rregulloren e ankandit.
- 11.10 Secili pjesëmarrës në ankand gjatë vendosjes së ofertave shkon në dhoma të veçanta dhe të ndara, të cilat do të përcaktohen në mënyrë të rastësishme.
- 11.11 Format i ankandit është njëkohësisht shumë – raundesh, që do të thotë se të gjitha blloqet në brezin 3400-3600 MHz dhe 3600 – 3800 MHz do të jenë njëkohësisht të hapura për oferta. Pjesëmarrësit mund të ofertojnë paralelisht për një bllok në brezin 3400-3600 MHz dhe disa blloqe (jo me shumë se 5 blloqe) në brezin 3600- 3800 MHz, procesi do të vazhdojë në disa raunde deri sa ankandi të konsiderohet i mbyllur (të përcaktohen fituesi).
- 11.12 Gjatë raundit aktiv, pjesëmarrësi duhet të paraqesë ofertë për vetëm një bllok në brezin 3400-3600 MHz dhe/apo një e më shumë blloqe (jo me shumë se 5) në brezin 3600-3800 MHz. Oferta e tillë duhet të ketë çmimin fillestar të raundit plus së paku një njësi ofertuese (*tutje; oferta minimale*) për bllokun e zgjedhur dhe/apo të përdor të drejtat e mbetjes në garë (waiver) më së shumti tre (3) raunde në total.
- Waiver i mundëson pjesëmarrësit të mbetet aktiv në ankand, ndërsa ofertës së tij i shtohet inkrementi mbi oferten maksimale të bllokut të raundit paraprak. Në rastet kur pjesëmarrësi nuk dorëzon ofertë apo waiver, komisioni do të aplikojë në mënyrë automatike waiver të mbetur për këtë pjesëmarrës.
- Pjesëmarrësi e dorëzon ofertën në formë të shkruar, në zarf të mbyllur, me mbishkrimin për bllokun për të cilin ofertohet. Në qoftë se pjesëmarrësi ka ofertën më të lartë për bllokun e zgjedhur, në raundin pasues ky pjesëmarrës duhet të ofertojë vetëm për këtë bllok deri në mbyllje të ankandit. Nëse dy apo më shumë pjesëmarrës japin ofertën më të lartë për një bllok, por me vlerë të barabartë, atëherë në raundin pasues këta pjesëmarrës mund të ofertojnë për cilindo nga blloqet e ankandit. Pjesëmarrësi i cili nuk e ka ofertën më të lartë, në raundin pasues mund të ofertojë për cilindo nga blloqet.
- 11.13 Çmimi fillestar për raundet pasuese formohet në atë mënyrë që ofertës më të lartë për bllokun përkatës të raundit paraprak i shtohet edhe çmimi inkremental.
- 11.14 Pas përfundimit të raundit aktual, menaxheri i ankandit me zë duhet t'i jap/bëj publike informacionet e mëposhtme;
- 11.14.1 ofertat e raundit aktual të dhëna nga çdo pjesëmarrës i ankandit;
- 11.14.2 ofertat e vendosura për secilin bllok të ankandit;

11.14.3 statusi i ankandit (blloqeve) – i hapur, i mbyllur, i përfunduar; dhe

11.14.4 çmimin fillestar, çmimin inkremental dhe kohën e hapjes së raundit pasues.

11.15 Ankandi vazhdon në disa raunde, përderisa pjesëmarrësit paraqesin ofertat për bllokun përkatës.

11.16 Komisioni i ankandit duhet t'i përjashtojë nga pjesëmarrja e mëtutjeshme pjesëmarrësit të cilët;

11.16.1 japin oferta të pavlefshme – shuma e ofruar është më e vogël se oferta minimale e pranueshme (*çmimi fillestar plus çmimi inkremental i raundit aktual*) apo vlera e ofertës nuk është e vlefshme (*ofertat e vlefshme janë dhënë në Shtojcën 3*);

11.16.2 japin oferta për më shumë se një bllok (për brezin 3410-3490/3510-3590 MHz);

11.16.3 nuk japin oferta fare në raundin e parë;

11.16.4 e tërheqin ofertën tashmë të dorëzuar/dhënë;

11.16.5 refuzojnë të nënshkruajnë protokollin e ankandit për ofertën më të lartë të dhënë.

11.17 Të gjitha blloqet mbetet të hapura për ofertim deri sa ofertat të mbyllen në çdo bllok. Ankandi përfundon në të njëjtën kohë në të gjitha blloqet pas raundit në të cilin nuk kemi më shumë se një ofertues për bllok, me ç'rast ofertuesit nuk paraqesin ndonjë ofertë të re ose shfrytëzojnë të drejtat e mbetjes në garë (waiver's).

Gjithashtu, Komisioni mund të aplikojë metodën e njohur si rregull e veçantë (*'special stopping rule'*) të përfundimit të ankandit. Në këtë rast, Komisioni deklaron dhe njofton pjesëmarrësit se ankandi do të përfundojë pas një numri të specifikuar të raundeve shtesë. Nëse Komisioni vendosë të aplikojë këtë rregull, atëherë në bazë të ofertave të pranuar në raundin final të caktuar Komisioni do të shpall rezultatet e Ankandit dhe konstatojë përfundimin e Ankandit.

11.18 Çdo pjesëmarrës duhet të nënshkruajë në protokoll ofertën e tij më të lartë.

11.19 Pjesëmarrësit kanë të drejtë që një herë gjatë ankandit të kërkojnë një pushim prej më së shumti dy (2) orësh deri në raundin ardhshëm për kohen vendos dhe e komunikon komisioni.

11.20 Në fund të çdo raundi pjesëmarrësit do të njoftohen mbi ofertat e dhëna nga të gjithë pjesëmarrësit në ankand.

11.21 Pjesëmarrësi i cili refuzon të nënshkruaj protokollin për ofertën e tij më të lartë, përjashtohet nga ankandi si dhe nga mundësia për të fituar. Fituesi vijues do të jetë

pjesëmarrësi i cili ka dhënë ofertën më të lartë sipas radhës, si dhe duke pasur parasysh edhe kushtet tjera në përputhje me rregullat e ankandit.

- 11.22 Në rastin kur nuk ka fitues vijues (*p.sh. pjesëmarrësi ka dhënë ofertën më të lartë në ndonjë bllok tjetër në raundin aktual dhe është klasifikuar si fitues, atëherë nuk mund të jetë edhe fitues i bllokut tjetër për të cilin ka ofertuar në raundin paraprak*) ai bllok mbetet i pa shitur. Nëse dy apo më shumë pjesëmarrës kanë dhënë ofertat më larta por të barabarta, ankandi vazhdon sipas procedurave të përshkruara në paragrafët e mëposhtëm.
- 11.23 Fitues i një blloku të caktuar është pjesëmarrësi i cili ka dhënë ofertën më të lartë për këtë bllok. Çdo pjesëmarrës në ankand mund të fitoj vetëm një bllok (*në brezin 3410 – 3490/3510 – 3590 MHz*).
- 11.24 Nëse ankandi mbyllet dhe dy apo më shumë pjesëmarrës kanë dhënë ofertën më të lartë por të barabartë për bllokun e njëjtë, ankandi vazhdon në formë të shkruar për këta pjesëmarrës. Secili nga këta pjesëmarrës mund të japin një ofertë të çfarëdoshme duke zgjedhur vetë vlerën e çmimit ofertues mbi oferten e fundit të dhënë . Në këtë rast, fitues do të jetë pjesëmarrësi i cili ka dorëzuar ofertën më të lartë.
- 11.25 Komisioni mund të kërkojë informacione shtesë nga pjesëmarrësi lidhur me pjesëmarrjen dhe kushtet e ankandit. Pjesëmarrësi duhet ti sigurojë informacionet e kërkuara dhe t'ia paraqesë komisionit në formë të shkruar brenda dy (2) ditë pune.
- 11.26 Në qoftë se komisioni gjen prova se pjesëmarrësi është pjesë e një kompanie të lidhur e përshkruar në paragrafët e mësipërm, konstaton se pjesëmarrësi ka paraqitur informacione jo të plota apo të pasakta, informacionet janë ndryshuar mirëpo pjesëmarrësi nuk e ka njoftuar paraprakisht komisionin, apo pjesëmarrësi refuzon ti paraqesë komisionit informacionet shtesë të kërkuara siç është përshkruar në pikën e mësipërme, atëherë komisioni ka të drejtë ta përjashtojë pjesëmarrësin e tillë nga ankandi dhe e drejta për të fituar.

12. Rezultatet e ankandit

- 12.1 Bordi i Autoritetit njoftohet me rezultatet e ankandit brenda 3 ditë pune, nga dita e mbylljes së ankandit dhe nxjerr vendim për të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave për fituesit e ankandit.
- 12.2 Në qoftë se nuk ka asnjë fitues në ankand, Bordi shpall mbylljen e ankandit.

13. Të drejtat e përdorimit të brezeve frekuencore

- 13.1 Fituesi brenda afati kohor të specifikuar me vendimin e Bordit, por JO më vonë se dyzet e pesë ditë (45) duhet të paguajë në llogarinë e Autoritetit shumën e ofertës fituese. Fatura e

paguar mund të dërgohet në mënyrë elektronike përmes e-mailit, të dorëzohet personalisht pranë Autoritetit apo të dërgohet me postë.

- 13.2 Në qoftë se fituesi nuk i përmbahet rregullave të përcaktuara në paragrafin e mësipërm, Bordi e tërheq pjesëmarrësin nga pozicioni i fituesit, me ç' rast të njëjtit i ndalet garancionit bankar. Fituesi i ri do të jetë pjesëmarrësi i cili ka pasur ofertën më të lartë me radhë. Në qoftë se nuk ka pjesëmarrës tjetër në atë bllok apo dy e më shumë pjesëmarrës kanë ofertat më të larta me radhë, por të barabarta, atëherë ai bllok mbetet i pa shitur.
- 13.3 Në qoftë se fituesi është përmbajtur të gjitha rregullave të përcaktuara, Autoriteti brenda dhjetë (10) ditë pune i lëshon Autorizimin fituesit.
- 13.4 Fituesi i ankandit ka të drejtën e shfrytëzimit të spektrit frekuencor të përcaktuar në përputhje me Ligjin për Komunikime Elektronike, rregulloret dhe vendimet e Autoritetit, Plani Kombëtar i Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Radiofrekuencor dhe rregullores për caktimin e rregullave të ankandit.
- 13.5 Në qoftë se fituesi nuk i përmbahet rregullave të përshkruara në paragrafin e mësipërm Autoriteti mund të vendosë që t'ia revokojë autorizimin apo të drejtat për shfrytëzimin e radio frekuencave operatorit të tillë.
- 13.6 Fituesi duhet ti paraqesë Autoritetit një herë në vit brenda periudhës 1 Janar – 15 Shkurt, një raport mbi shfrytëzimin e brezit frekuencor 3400 – 3800 MHz (*bllokut përkatës brenda këtij brezi*), i cili duhet të përmbajë së paku informacionet të përcaktuara konform kërkesave të Autoritetit.